

**VENDIM**  
**Nr. 124, datë 3.3.2021**

**PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE  
TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA PROJEKTI  
“NDËRHYRJA POLIFUNKSIONALE NË LAGJEN ‘XHEVDET NEPRAVISHTA’,  
LUSHNJË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti “Ndërhyrja polifunksionale në lagjen ‘Xhevdet Nepravishta’, Lushnjë”.
  2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Lushnjë.
  3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës së kompensimit përkatës, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, me vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 6 178 808 (gjashtë milionë e njëqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e tetëqind e tetë) lekësh.
  4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 6 178 808 (gjashtë milionë e njëqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e tetëqind e tetë) lekësh, të përballohet nga buxheti i Bashkisë Lushnjë.
  5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.
  6. Afati i përfundimit të shpronësimit të jetë brenda tre muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
  7. Pronarët e pasqyruar në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin për likuidim, certifikatën e pronësisë, kartelën e pasurisë, si dhe hartën treguese të regjistrimit pranë Bashkisë Lushnjë.
  8. Bashkia Lushnjë të kryejë procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar.
  9. Afati i përfundimit të punimeve të jetë në përputhje me afatet e parashikuara.
  10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Lushnjë, në bashkëpunim me Bashkinë Lushnjë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, të fillojnë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartat kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar dhe të bëjnë kalimin e pronësisë në favor të Bashkisë Lushnjë.
  11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Lushnjë, të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuar, deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartat kadastrale dhe kalimi i pronësisë në favor të Bashkisë Lushnjë.
  12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Lushnjë, si dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Lushnjë, për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR**  
**Erion Braçe**

LISTA EMËRORE E PRONARËVE TË PASURIVE PRONË PRIVATE, QË SHPRONËSOHEN  
NGA ZBATIMI I PROJEKTTIT “NDËRHYRJA POLIFUNKSIONALE NË LAGJEN ‘XHEVDET  
NEPRAVISHTA’, LUSHNJË”

| Nr.                 | Emër Atësi<br>Mbiemër     | ZK   | Nr. i pas. | Lloji i<br>pasurisë | Sip. e<br>prekur<br>truall<br>(m <sup>2</sup> ) | Çmimi për<br>truall<br>(lek/m <sup>2</sup> ) | Vlera, truall i<br>prekur (lek) | Konfirmimi nga ASHK, Drejtoria Vendore Lushnjë                                             |
|---------------------|---------------------------|------|------------|---------------------|-------------------------------------------------|----------------------------------------------|---------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------|
| 1                   | Shaban Tefik Xhafa        | 8571 | 27/109     | Truall              | 37                                              | 9,709                                        | 359,233                         | Shkresa nr. 10459/1, datë 20.10.2017. Shkresa nr. 751/3, datë 29.9.2020.                   |
| 2                   | Valentina Ruzhdi<br>Xhafa | 8571 | 27/111     | Truall              | 17                                              | 9,709                                        | 165,053                         | Shkresa nr. 10459/1, datë 20.10.2017. Shkresa nr. 751/3, datë 29.9.2020.                   |
| 3                   | Skënder Murat Senka       | 8571 | 25/76      | Truall              | 37                                              | 9,709                                        | 359,233                         | Shkresa nr. 10459/1, datë 20.10.2017. Shkresa nr. 751/3, datë 29.9.2020.                   |
| 4                   | Sefedin Karafil Troka     | 8571 | 25/216     | Truall              | 27                                              | 9,709                                        | 262,143                         | Shkresa nr. 10459/1, datë 20.10.2017. Shkresa nr. 751/3, datë 29.9.2023.                   |
| 5                   | Vasillaq Uani Prence      | 8571 | 25/297     | Truall              | 44.4                                            | 9,709                                        | 431,080                         | Shkresa nr. 419/1, datë 13.3.2018. Shkresa nr. 751/3, datë 29.9.2020.                      |
| 6                   | Hamit Hekuran Çala        | 8571 | 25/309     | Truall              | 338                                             | 9,709                                        | 3,281,642                       | Shkresa nr. 12266/1, datë 9.1.2019. Vertetim hipotekor nga ZVRPP Lushnjë, datë 29.12.2018. |
| 7                   | Astrit Arif Xhafa         | 8571 | 25/218     | Truall              | 136                                             | 9,709                                        | 1,320,424                       | Shkresa nr. 2318, datë 11.3.2020.                                                          |
| <b>SHUMA TOTALE</b> |                           |      |            |                     | <b>636.4</b>                                    |                                              | <b>6,178,808</b>                |                                                                                            |

**SHËNIM:**

1. Për truallin, çmimi i llogaritur është marrë nga VKM-ja nr. 89, datë 3.2.2016.

